**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2781/2 Prot

Rrëshen më, 06. 08. 2025

# V E N D I M

**Nr. 63 datë 01. 08. 2025**

## "PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË Z. NDUE NIKOLL NIKOLLI, FSHATI GËZIQ, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË" DHE *PËRDORIM FONDI MBROJTJES CIVILE*

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", në ligjit nr.115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKB nr.115 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", si dhe projekt-vendimin së bashku me relacionin nr. 2781 prot, datë 14.07.2025, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 28.07.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

## V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile, në shumën 200 000 (*dyqind mijë*) lekë, për dhënie ndihmë financiare familjarëve të të ndjerit Ndue Nikoll Nikolli, fshati Gëziq, njësia administrative Rrëshen, bashkia Mirditë, për rast fatkeqësie në familje.

   - **Përdorim Fondi, Mbrojtje Civile; ( Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 604 kod prod 91707AB) për shumën;...............................................................................................200 000 lekë**

2. Pagesa të kalojë me bordero pranë Postës Shqiptare, dega Mirditë, në emër të Znj. Marjana Ndue Nikolli, bashkëshortja e të ndjerit, mbajtëse e kartës identitetit me NID: G95627057Q, fshati Gëziq, njësia administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Mirditë (drejtoria zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave, agjencia inspektimit, kontrollit dhe emergjencave)

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.*

**S E K R E T A R**

**Gaspër TOPOLLAJ**

**K R Y E T A R**

**Aleksandër PICAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI" RRËSHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov

**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2781/1 Prot. Rrëshen, me 14/07/2025

**P/V E N D I M**

**Nr. 62 datë 14. 07.2025**

**"PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË Z. NDUE NIKOLL NIKOLLI, FSHATI GËZIQ, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË" DHE *PËRDORIM FONDI MBROJTJES CIVILE***

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", në ligjit nr.115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKB nr.115 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025",dhe relacionin për ndihmë financiare familjes së Z. Ndue Nikoll Nikolli, këshilli i Bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile, në shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë për dhënie ndihmë financiare familjarëve të ndjerit Ndue Nikoll Nikolli, fshati Gëziq, Njësia Administrative Rrëshen për rast fatkeqësie në familje.

***Fondi mbrojtje civile( Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 604 kod prod 91707AB )për shumën 200.000 lekë***

2. Pagesa të kalojë me bordero pranë Postës Shqipëtare dega Mirditë në emer të Znj. Marjana Ndue Nikolli,bashkëshortja e të ndjerit, mbajtëse e kartës identitetit me NID: G95627057Q fshati Gëziq, Nj. A Rrëshen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë (drejtoria zhvillimit ekonomikb dhe tatim taksave, agjencia inspektimit, kontrollit dhe emergjencave)

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETARI**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**KRYETARI**
**Aleksandër PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr. AIKE: F.Vorfi
Dr.Juridike, prok, protokoll: M. Doda
Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

**KRYETARI**
**Albert MELYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov

BASHKIA MIRDITË

Nr. 2781 Prot. Rrëshen, me 14/07/2025

**RELACION**

**PËR PROJEKT-VENDIMIN PËR "DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË Z. NDUE NIKOLLI, FSHATI GËZIQ, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN"**

**Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Mirditë**

***Të nderuar këshilltarë,***

Me datën 07.05.2025 në Fshatin Gëziq, të NJ.A Rrëshen në rezervuarin e fshatit është mbytur shtetasi Ndue Nikoll Nikolli, 56 vjeç. Menjeherë pas marrjes së njoftimit rreth ngjarjes janë angazhuar e gjithë struktura vendore e bashkisë, MZSH, EC, Policia e Shtetit, Urgjenca për gjetjen dhe nxjerrjen e trupit të ndjerit por pa rezultat. Pas kërkesës pranë AKMC për mbështetje me ekip të specializuar polumbarësh është bërë e mundur nxjerrja e trupit të të ndjerit.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe të VKM Nr.329 datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kreu 111, pika 3 gërma a"* dhe në kërkesës me nr. 1912 prot, datë 15.05.2025 drejtuar bashkisë Mirditë për ndihmë pasi kushtet financiare janë të pamjaftueshme për jetesën e kësaj familje, propozojmë akordimin e shumës prej 200.000 lekë si ndihmë për familjarët.

Bashkëngjitur do gjeni kërkesën drejtuar Prefektit Qarkut për mbështetje, çertifikatë familjare, çertifikatën e vdekjes, raportin e shërbimit mbajtur nga shërbimi MZSH.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin !

**Hartuan projektin:**

Drejtori AIKE: Frederik VORFI

Përgj/ Sekt. EC: Ilir GJINI

**KRYETARI**
**ALBERT MELYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

Lidhja XIII

# FLETË NJOFTIMI

**Për ndërhyrjen e kryer Nr:** 32 (Tridhjete e dy).

Objekti ku ndërhyet: Rezervuari Gezig.
~~Adresa ku ndërhyet: Gëzig~~
Arsyeja përse ndërhyet: Për të nxjerr një të mbytur nga rezervuari.
Personi që njofton: Salla operative, Numri i telefonit të njoftuesit: 0694110238.
Data e njoftimit: 07/05/ 2025, Ora e e njoftimit: 06 e 00 minuta.
Data e daljes nga Stacioni: 07/05/ 2025, Ora e daljes nga Stacioni: 06 e 03 minuta.
Data e mbërritjes në objekt: 07/05/ 2025, Ora e mbërritjes në objekt: 06 e 20 minuta.
Data e daljes nga objekti: 07/05/ 2025, Ora e daljes nga objekti: 14 e 00 minuta.
Data e hyrjes në Stacion: 07/05/ 2025, Ora e hyrjes në Stacion: 14 e 25 minuta.
U verifikua njoftimi me numërin e telefonit të njoftuesit: 0694110238
dhe rezultoi se ishte i Saktë.
**Shënime:** LEVIZJA E PERSONELIT ZJARFIKES U BE ME DY DALJE DHE LEVIZJET ME DY MAKINA AUT. ZJ "AA 849 JZ" DHE AUT. AB 375 AN.

Punonjësi i informacionit
Kristjan Ndoka
[signature]

Lidhja XIV

# RAPORTI

**Për ndërhyrjen e kryer Nr:** 32 (TRIDHJETE E DY).

Efektivi i gatshëm i Stacionit të M.Z.SH.-së Mirditë me të marrë sinjalin e ardhur nga: SALLA OPERATIVE, me numër telefoni: 0694110238
për ndërhyrjen në: PER TE NXJERRE NJE PERSON TE MBYTUR NE REZ.
me adresë: GEZIQ.
Koha e zgjatjes së ndërhyrjes: 505 (PESEQIND E PESE.) minuta.
Koha e punës së automjetit zjarrfikës në vënd kur ndërhyet: — (—) minuta.
Koha e punës së automjetit zjarrfikës në vënd: — (—) minuta.
Distanca nga Stacioni i M.Z.SH.-së: 14 + — = 14 (KATERMBEDHJETE) kilometër.
Koha e punës së paisjes zjarrfikëse në ndërhyrjet: — (—) minuta.
Shkaku përse ndërhyet: PER TE NXJERRE NJE PERSON TE MBYTUR NE REZ.
Mjetet e ndërhyrjes: AUT. ZJ "AA 849 JZ" DHE AUT. AB 375 AN.
Sasia e ujit të përdorur: — + — + — = — (—) metër kub (m³).
Dëme në persona, të plagosur: Po / Jo, Nr ___ (—) veta, Të vdekur: Po / Jo, Nr 1 (NJE.) veta.
Pronari i objektit ku ndërhyet: BASHKIA MIRDITE.
Përshkrimi i veprimeve operacionale: MORRE PJESE NE NXJERRJEN E TE VDEKURIT NGA MIKROCI NGA REZERVARI I UJIT I FSHATIT GEZIQ

**Komandanti i Shërbimit**
U.B.SH. Gjini
[signature] 2025

**Komandanti Stacionit MZSH**
Benardin Bliu
[signature]